



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1991/ 5prot

Datë 22.09.2022

V E N D I M
Nr. 912/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.09.2022 me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar - shërbime - me mjete elektronike”, me Nr. REF- 37974-08-05-2022, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në tre Njësitë Prodhuese KESH sh.a”, me fond limit 6.350.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.08.2022 nga autoriteti kontraktor KESH Sh.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK
Adresa: Zona kadastrale 2679, hyrja 2, apartamenti 39, Mëzez, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** KESH Sh.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa: Lagjja nr. 1, Rruga “Tregtare”, Durrës.
- Baza Ligjore:** Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08-08-2022, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar - shërbime - me mjete elektronike*”, me Nr. REF- 37974-08-05-2022, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në tre Njësitë Prodhuese KESH Sh.A”, me fond limit 6.350.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.08.2022 nga autoriteti kontraktor KESH Sh.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

II.2. Në datën 08.09.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.3. Në datë 09.09.2022 autoriteti kontraktor ka kryer publikimin e Njoftimit të anulimit të procedurës objekt-ankimi.

II.4. Në datën 14.09.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.1991 e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, për procedurën

e prokurimit, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së, mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1991/2 prot., datw 15.09.2022, janë publikuar arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK ngre pretendime.

II.6. Me shkresën nr. 4601/3 prot, datë 19.09.2022 protokolluar me tonën me nr. 1991/4 prot datë 21.09.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor me vendimin Nr. 4601/3 prot, datë 19.09.2022 ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon:

“..Komisionit të shqyrtimit të ankesës nga ana e Komisionit të vlerësimit të ofertave ju vu në dispozicion vlerësimi i bërë për Operatorin Ekonomik "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" ShPK dhe dokumentacioni i paraqitur nga ky operator në SPE. KSHA pas kontrollit në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit konfirmoi certifikatën e Akreditimit të paraqitur nga ky operator ekonomik.

Për sa i takon analizave COD, DO,BDO, N-NO2 dhe analizave të tjera për të cilat ky operator është i akredituar, ankimuesi sqaron specifikat dhe mënyrat e kryerjes së tyre. KSHA pas sqarimit të dhënë nga ankimuesi bëri krahasimin e analizave të kërkuara nga AK me ato të paraqitura në listën e analizave për të cilat është i vlefshëm akreditimi për këtë operator. KSHA konstaton se analizat e paraqitura nga operatori për të cilat është i vlefshëm akreditimi janë në përputhje me analizat e kërkuara nga AK, pasi si edhe është sqaruar në ankesë ato ose janë të njëjta ose janë ekuivalente të analizave të kërkuara.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Sa më sipër mbështetur në nenin 114 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 102 të VKM Nr. 285, datë 19/05/2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit", i ndryshuar, AK KESH sh.a vendos:1- Pranimin e ankesës së operatorit ekonomik "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" ShPK, për procedurën e prokurimit publik me objekt: "Monitorimi i treguesve mjedisor në tre Njësite Prodhuese KESH sh.a", NR. REF-37974-08-05-2022.

II.7. Në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëlidhur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK mbi kundërshtimin vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 4601/3 prot, datë 19.09.2022 protokolluar me tonën me nr. 1991/4 prot datë 21.09.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezultoi, se autoriteti kontraktor me vendimin Nr. 4601/3 prot, datë 19.09.2022 ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon:

“..Komisionit të shqyrtimit të ankesës nga ana e Komisionit të vlerësimit të ofertave ju vu në dispozicion vlerësimi i bërë për Operatorin Ekonomik "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" ShPK dhe dokumentacioni i paraqitur nga ky operator në SPE. KSHA pas kontrollit në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit konfirmoi certifikatën e Akreditimit të paraqitur nga ky operator ekonomik.

Për sa i takon analizave COD, DO,BDO, N-NO2 dhe analizave të tjera për të cilat ky operator është i akredituar, ankimuesi sqaron specifikat dhe mënyrat e kryerjes së tyre. KSHA pas sqarimit të dhënë nga ankimuesi bëri krahasimin e analizave të kërkuara nga AK me ato të paraqitura në listën e analizave për të cilat është i vlefshëm akreditimi për këtë operator. KSHA konstaton se analizat e paraqitura nga operatori për të cilat është i vlefshëm akreditimi janë në përputhje me analizat e kërkuara nga AK, pasi si edhe është sqaruar në ankesë ato ose janë të njëjta ose janë ekuivalente të analizave të kërkuara.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Sa më sipër mbështetur në nenin 114 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 102 të VKM Nr. 285, datë 19/05/2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit", i ndryshuar, AK KESH sh.a vendos:1- Pranimin e ankesës së operatorit ekonomik "Qendra e Monitorimit të Mjedisit" ShPK, për procedurën e prokurimit publik me objekt: "Monitorimi i treguesve mjedisor në tre Njësiti Prodhuese KESH sh.a", NR. REF-37974-08-05-2022.

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar - shërbime - me mjete elektronike”, me Nr. REF- 37974-08-05-2022, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në tre Njësitë Prodhuese KESH Sh.A”, me fond limit 6.350.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.08.2022 nga autoriteti kontraktor KESH Sh.A (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK.

4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro